



GARË MATEMATIKORE NË KOMUNA PËR NXËNËSIT E SHKOLLAVE NËNTËVJEÇARE

25.02.2017

Klasa e 4

1. Janë dhënë numrat 1,2,3,4,5,6,7,8 dhe 9. Shënoni me diagrama të Venit bashkësitë A dhe B, të tilla që bashkësia A është e përbërë nga numra në shkrimin e të cilëve përdoren linja të drejta ose të pjerrta, ndërsa bashkësia B është e përbërë nga numra në shkrimin e të cilëve përdoren vija jo të drejta(lakuara).


2. Mendova një numër treshifror. Shuma e shifrave të tij është 15. Shifra e njëshave është për 5 më e vogël se 14. Shifra e dhjetshave është më e madhe se 0 dhe më e vogël se 2. Cilin numër mendova?

3. Nxënësit e klasës së katërt shkuan në eskursion. Ata udhëtonin me 3 autobusë me nga 32 nxënës në secilin autobus. Në hotelin ku qëndruan flinin në dhoma me dy krevate. Sa dhoma gjithsej ishin zënë nga nxënësit?

4. Katror me gjatësi të brinjës 4cm është i ndarë në 16 katrorë të vegjël me gjatësi të brinjës 1cm (shiko vizatimin).

a) Sa katrorë ka në vizatim?

b) Sa segmente ka në vizatim?





GARË MATEMATIKORE NË KOMUNA PËR NXËNËSIT E SHKOLLAVE NËNTËVJEÇARE

25.02.2017

Klasa e 5

1. Ana duhet të shpërndajë ftesa për dasmën e motrës së saj. Ajo ka 2 pako me ftesa dhe secila pako ka 24 ftesa. Duhet të ftojë 60 mysafirë. A do të ketë Ana numër të mjaftueshëm ftesash për të gjithë mysafirët? Sqaroje me fjalë përgjigjen tënde.

2. Në qotë se nga shuma e numrit më të madh katërshifror me shifra të ndryshme dhe numrit më të vogël pesëshifror me shifra të ndryshme zbrit numër të panjohur do të fitosh 20000. Përcaktoje numrin e panjohur.

3. Luli është 5cm më i gjatë se Tani, i cili është 20cm më i shkurtër se Mira. Përcaktoje gjatësinë e secilit fëmijë, nëse të tre së bashku janë të gjatë gjithsej 475cm.

4. Brinjët një drejtkëndëshi janë 21 cm dhe 7 cm. Me një drejtëz ai është i ndarë në një katror dhe një drejtkëndësh. Sa është ndryshimi i perimetrave të figurave të krijuara.



**GARË MATEMATIKORE NË KOMUNA
PËR NXËNËSIT E SHKOLLAVE
NËNTËVJEÇARE**

25.02.2017

Klasa 6

1. Përcaktoi këndet shtuese α dhe β të tilla që këndi α është për 12° më i madh sesa β .

2. Nëna e Oliverës solli karta identifikuese dhe planifikonte t'ia ndante shoqeve të saj. Kur mendoi se si t'ia ndante 4, 5 ose 6 shoqeve të saj, gjithmonë i ngelej nga 1 kartë identifikuese. Sa karta më së pakti kishte nëna e saj?

3. Aleksandri dhe Eleonora hanë mëngjes. Ndërsa Eleonora ha nga 2 kifla, Aleksandri ha nga 4 kifla. Pas mëngjesit u pa se Aleksandri hëngri 6 kifla më shumë se Eleonora. Sa kifla hëngrën të dy së bashku?

4. Cilat shifra duhet të qëndrojnë në vendet a, b me qëllim që shuma e numrave $\overline{323a} + \overline{b410}$ të plotpjestohet me 9?



GARË MATEMATIKORE NË KOMUNA PËR NXËNËSIT E SHKOLLAVE NËNTËVJEÇARE

25.02.2017

Klasa 7

1. Nga një shishe me lëng të koncentruar prej 750 *ml* mund të mbushen 16 prej 250 *ml*. Sa shishe dhe sa mililitra limonadë e koncentruar duhen që të fitohen 12 *l* limonadë e tretur?

2. Në regjionin e këndit $\angle AOB$ janë hequr përgjysmorja OC dhe gjysmëdrejtëza OD kështu që $\angle AOD$ është $\frac{1}{5}$ e këndit $\angle AOB$. Llogarite këndin $\angle AOB$, nëse $\angle COD = 30^\circ$.

3. Në një shkollë 30% e nxënësve janë më të vegjël se 10 vjeç, $\frac{1}{20}$ kanë saktësisht 10 vjet, $\frac{3}{10}$ janë më të mëdhenj se 10 por më të vegjël se 12 vjet, ndërsa 70 nxënësit e tjerë kanë 12 vjet dhe më tepër. Sa nxënës kanë saktësisht 10 vjet?

4. Është dhënë paralelogram $ABCD$ dhe pika M në brinjën AB kështu që $\angle AMD = \angle CMD$. Vërteto që nëse pika P është mesi i segmentit MD , atëherë $CP \perp DM$.




GARË MATEMATIKORE NË KOMUNA PËR
NXËNËSIT E SHKOLLAVE
NËNTËVJEÇARE

25.02.2017

Klasa 8

1. Mendova një thyesë. E shumëzova me thyesën $\frac{5}{6}$, pastaj i shtova thyesën $\frac{3}{4}$ dhe fitova thyesën $\frac{5}{4}$. Cilën thyesë e mendova?



2. Drejtkëndëshi në vizatimin (shiko vizatimin) djathtas është i përbërë nga katrorë të barabartë të vegjël dhe ka suprinë 252cm^2 . Përcaktoje suprinën e katërkëndëshit $ABCD$.

3. Në tre arka ka 72 kg. mollë. Në arkën e parë ka $\frac{4}{5}$ herë më shumë sesa në të dytën, ndërsa në të tretën ka 12 kilogramë më pak se në të dytën. Nga sa kilogramë mollë ka në secilën arkë?

4. Përcaktoji të gjithë numrat e thjeshtë p të tillë që edhe numri $p^3 + 3^p$ është i thjeshtë.



GARË MATEMATIKORE NË KOMUNA PËR NXËNËSIT E SHKOLLAVE NËNTËVJEÇARE

25.02.2017

Klasa 9

1. Nga vendet A dhe B me largësi prej njëri-tjetrit 120km njëkohësisht nisen njëri kundrejt tjetrit dy biçiklistë. I pari me shpejtësi $10\frac{4}{5}\text{km/h}$, ndërsa i dyti me $12,5\text{ km/h}$. Pas sa kohësh nga nisja biçiklistët do të takohen?

2. Nëse $\frac{y}{x}=3$, llogarite vlerën e thyesës $\frac{3y^2-2xy+x^2}{x^2+xy+y^2}$.

3. Është dhënë trekëndëshi ABC . Nëpërmjet pikës B heqim një drejtëz paralele me brinjën AC . Në drejtëz zgjedhim dy pika X dhe Y të tilla që X dhe A ndodhen në të njëjtin gjysëmrrafsh të përcaktuar me drejtëzën BC , ndërsa Y dhe C ndodhen në të njëjtin gjysëmrrafsh të përcaktuar me drejtëzën AB . Për këndet $\angle XBA, \angle ABC$ dhe $\angle YBC$ vlen $\angle XBA:\angle ABC:\angle YBC=3:10:5$. Gjeji këndet e trekëndëshit ABC .

4. Zgjidhe ekuacionin në bashkësinë e numrave natyrorë.

$$\sqrt{x} + \sqrt{y} = \sqrt{48}.$$